



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.315/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor: Besart Ademi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Dega në Viti paraqitur kundër kolaicionit NISMA-AKR, me seli në Prishtinë, Dega në Viti, për shkak të vendosjes së posterit në afërsi të qendrës së votimit 100 metra, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Anr.315/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që kolaicionit NISMA-AKR, t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes - vendosjes së posterit të kandidatit të tyre për deputet Kastriot Sylejmani, në ditën e votimit në një perimetër më afër se 100 metra distancë nga Qendra e Votimit, në ditën e heshtjes zgjedhore.

#### A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Dega në Viti, me datën 05.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2019, subjekti politik NISMA, ka bërë shkelje të rregullave zgjedhore, shpërndarje të materialit zgjedhor, gjegjësisht nuk e ka hequr foto-posterin afër një vendvotimi siç shihet në foto.

Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen në rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Nuk është kontestues fakti se përmes fotografisë së dërguar si provë vërehet poster i kandidatit për deputet nga radhët e NISMA-AKR, i vendosur në afërsi të ndonjë vendvotimi.

Paneli, vlerëson se në bazë të fotografisë së prezantuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 paragraf 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu që në afërsi të Qendrës së Votimit në një distancë më të afërt se 100 metra është i vendosur poster i kandidatit i NISMA-AKR Kastriot Sylejmani.

Në fotografi shihet vetëm poster i ndërsa qendra e votimit nuk shihet, nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet qendra e votimit, dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të qendrës së votimit, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj. Po ashtu nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe bindëse se në foton e ofruar si dëshmi nuk shihet ndonjë qendër e votimit afër, posterit të vendosur.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.315/2019 më datën 07.10.2019

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.

**Kryesuese e Panelit**

